

**JAVA E MADHE E SHENJTE  
E HENA E MADHE**

**SHERBESA E DHENTERRIT I**

*Kjo Shërbesë bëhet të Dielën e Pallmave mbrëmë. Passi bekon Pifti, thuhet Trishenjtë, pastaj:*

**KENDONJESI:** Mëshiro, o Zot. (12 herë).

Ejani t'i falemi dhe t'i përgjunjemi Krishtit, Perëndisë dhe Mbretit tonë. (3 herë).

*Pastaj këndohen ngadale të dy Psalmet pasonjës, dhe Pifti temjanis Kishën edhe popullin me kacinë:*

**PSALMI 20**

Të dëgjoftë Zoti ditën e shtrëngimit, të mproftë emri i Perëndisë së Jakobit. Të dërgoftë ndihmë nga Shenjtërorja, dhe të forcoftë nga Siona. I kujtoftë të gjitha theroret e tua, dhe ta pëlqeftë hollokokstin. Të dhëntë Zoti sipas dëshirës, dhe ta mbaroftë tërë këshillën. Do të gëzohemi për shpëtimin e Perëndisë, dhe do ta ngremë flamurin përjetë më emrin e tij. Zoti na i mbaroftë të gjitha kërkesat. Tani e di se Zoti e shpëton të drejtin. Do ta dëgjonjë nga qjell i shenjtë, dhe do ta mpronjë me dorën e djathtë. Disa mburren me qere, disa me kuaj, po ne do ta kujtojmë emrin e Zotit Perëndisë sonë. Ata u-pëmbysnë dhe ranë; po ne u-ngritmë, dhe qëndruam drejt. Shpëtona, o Zot; dëgjona, o Mbret, kur të thërresim.

**PSALMI 21**

Mbreti do të gëzohet me fuqinë tënde, o Zot, edhe do të ngazëllohet me shpëtimin tënt. Ia mbarove dëshirën e zemrës, dhe ia dëgjove kërkesat e buzëve. E arive me bekime të mira, dhe i vure mi krye kurorë prej ari të kulluar. Të kërkoj jetë, dhe i dhurove ditë të gjata për gjithënjë. E lavdërove, dhe e shpëtove; i dhurove nder dhe madhësi. Se e bekove për jetë, dhe e gëzove me fytyrën tënde. Se mbreti shpëren më Zotin, dhe mbetet i patundur me mëshirën e të Lartit. Dora jote do t'i gjenjë të gjithë armiqtë, e djathta jote do t'i përmbysë ata, që të urrejnë. Do t'i djegësh posi furrë kur të zëmërohesh, edhe do t'i përpish me zjarr. Do tua prishësh pemët prej dheut, edhe do tua shuash farën nga mezi i njerësve. Se u-mejtuan të këqia kundër teje, dhe bënë pllane të paudha. Përandaj do t'i prapsësh, kur

t'i gatitësh shigjetat kundër tyre. Lartësohu, o Zot, me fuqinë tënde; do t'i këndojmë, dhe do t'i psallim poetat e tua.

*Pastaj Këndonjësi vazhdon:*

Ti shpëtoje Zot edhe ti bekoje popullin . . . .

LAVDI. Ti që u-ngrite përmi Kryq dyke dashur . . . .

TANI .Mprojtëse e lavdëruar dhe e patronditur . . . .

*Pastaj thuhet Litania e Gjerë, të Gjashtë Psalmet, edhe Litania e Madhe. (Shiko Uratoren, f.20-29). Pastaj Vallet këndojnë katër herë "Alilluia" në Tingëllin Tërthor IV me Vargjet pasonjës:*

*I. Me Shpirtin tim të dëshërova natën, o Perëndi, përpara agimit.*

Alilluia, alilluia, alilluia.

*II. Gjykimet e tua janë mi dhenë; ndënjësit e saj do të mësojnë drejtësi.*

Alilluia, alilluia, alilluia.

*III. Populli, i cili nuk është munduar, do të këtë zili.*

Alilluia, alilluia, alilluia.

*IV. Ua shtove të këqiat të lartëve të dheut, o Zot.*

Alilluia, alilluia, alilluia.

*Pastaj këndohet dy herë ngadale dhe një herë shkurtër:*

TROPARI I DHENTERRIT, T. III.

IDHU O NIMFIOS ERKHETE

Ja dhëntërri ynë Zoti Krisht, mun në mes të natës vjen; edhe lum' ay të cilin, do ta gjenje vigjëllonjës,

edhe mjer' ay të cilin do ta gjenjë plogëronjës. Shpirti im kij mëndjen, se dremitja përdhe të shtrin, edhe vdekja e tmerrshime të përpin, jashtë Mbretërisë djalli të grin; po zgjohu thirr me një zë të math: Shenjt je, Shenjt je ti, Shenjt je ti o Perëndi, me lutjet e Shën Marisë, mëshirë kij për ne. (3 herë).

NDENJESORET, T. I.

PAS TON TAFON SU SOTIR

E sotmja ditë nis, me shkëlqim dhe me dritë, Pësimet e mëdha, për shpëtimin e botës, se Krishti për së shpejti vjen, të pësonjë me mirësi, Zot' i Math që mban, në grusht të tij gjithësinë, bashkëzbret për ne, dhe kryqësohet mi drurin, për ndjesën e fajëve.

LAVDI DHE TANI. *Gjithajo.*

Me trup si na u-pe, i padukur Gjykatës, të vritesh vjen tani, nga ca njerës keqbërës, dënimet na i shpërllan, me Pësimet e tmerrshime; këngë dhe lavdi, dhe madhëstim të dërgojmë, me një zëmr' e zë, për forcën tënde të madhe, o Zot i mëshirave.

LAVDI DHE TANI. *Gjithajo.*

PAS TIN SOFIAN KE LOGON, T.T.IV.

Jav' e Madhe e Shenjtë nis me shkëlqim, me Pësimet e Krishtit plot me vajtim; eni pra dhe priteni, kremtërojeni besërisht. Krijetari ja ku vjen, të vuanjë Kryq për ne, me hetime dhe kamçik përpara gjykatësit; pret për ne shuplaka, dhe përqeshje prej robërsh, të gjitha po i pranon, për shpëtimin e njerësve. Përandaj pra thirrini: O Krisht Perëndi dhe Zot, ti dhurona ndjesën

e mëkatave, që t' adhurojmë me besë, Pësimet e hidhura.

LAVDI DHE TANI. *Gjithajo.*

*Dhe menjëherë Dhjaku thotë:*

DHJAKU: Dhe që të vlerësohemi ta dëgjojmë Ungjillin e Shenjtë, Zotit Perëndisë tonë le t'i lutemi.

KORI: Mëshiro, o Zot. (3 herë)

DHJAKU: Urtësi, o të drejtë. Le ta dëgojmë Ungjillin e Shentjë.

PRIFTI: Paqe të gjithëve.

KORI: Dhe me frymën tënde.

DHJAKU: Këndimi prej Ungjillit të Shenjtë pas Mattheut.

PRIFTI: Le të vëmë re.

KORI: Lavdi më ty, o Zot, lavdi më ty.

*Pastaj Prifti këndon Ungjillin:*

### UNJILLI PAS MATTHEUT

Më atë kohë, kur kthehej Jesuj në qytet, e zuri uria. Dhe pa një dru fiku mbë udhë, dhe iu-afrua, po nukë gjeti veçse fletë, edhe i tha: “Mos bëfsh më pemë për jetë.” Dhe menjëherë u-tha druri i fikut. Edhe kur e panë, dishepujtë u-çuditnë, dhe thanë: “Qysh u-tha druri i fikut menjëherë?” Dhe Jesuj u-përgjeq, edhe u tha: “Me të vërtetë po ju them, po të kini besë dhe të mos dyshoni, do të bëni punë jo vetëm si këtë të fikut, po edhe në i thënçi këti mali, ‘Ngrehu dhe hidhu në det’, do të bëhet. Dhe të gjitha lypjet, që do të bëni me lutje dhe me besë, do t'i merrni.”

Dhe kur ardhi në tempull, iu-afruan Kryepriftinjtë dhe pleqtë e popullit tek mësonde, dhe e pyetnë: “Me ç' farë fuqi i bën këto? Dhe kush ta ka dhënë këtë fuqi?” Edhe Jesuj u-përgjeq, edhe u tha: “Do tju pyes edhe unë një fjalë, dhe po të më përgjigjeni, adhere do tju përgjigjen edhe unë me ç' fuqi i bën këto: Nga ishte pagëzimi i Joanit, nga qjelli apo nga njerëzit?” Edhe ata mejtohëshin më vete, dhe thoshin: “Në thënçim, ‘Nga qjelli’, do të na pyesë, ‘Përse pra nuk e besuat?’ Edhe në thënçim, ‘Nga njerëzit’, kemi frikë nga gjindja, se të gjithë e besojnë Joanin si Profet.” Edhe iu-përgjeqnë Jesujt, edhe i thanë: “Nukë dimë.” Edhe ay u tha: “As unë nukë ju them me ç'farë fuqi i bën këto. Po si besoni? Një njeri kishte dy bij; edhe i vajti të parit, edhe i tha: “Bir, shko, dhe puno në vreshtën.” Edhe ay u-përgjeq, edhe i tha: “Nukë dua të vete.” Po pastaj u-pendua, dhe vajti. Pastaj i vajti të dytit, edhe i tha gjithashtu. Edhe ay u-përgjeq, edhe tha: “Do të vete, o Zot.” Edhe nukë vajti. Cili nga të dy mbaroj dëshirën e t' atit?” Edhe ata iu-përgjeqnë: “I pari.” Dhe Jesuj u tha: “Me të vërtetë po ju them se publikanët edhe lavirat do të venë në Mbretërinë e Perëndisë më parë se ju. Se Joani ju tregoj udhën e drejtësisë, dhe ju nuk e besuat; po publikanët edhe lavirat e besuan; dhe ju e patë, po prapë nuk u-penduat as e besuat pastaj.

Dëgjoni një tjetër parabolë: Ishte një njeri, i zoti i shtëpisë, i cili mbolli një vreshtë, dhe thuri një garth, edhe mihu një tirë, dhe ndërtoj një pyrk, edhe ua dha disa bujqve, dhe shkoj në mërgim. Edhe kur u-afrua koha e pëmëve, dërgoj shërbëtorët në bujqërit për të marrë pemët. Edhe bujqërit i zunë shërbëtorët edhe cilin e rrah-në, cilin e vranë, dhe cilin e lapidian. Përsëri i zoti dërgoj të tjerë shërbëtorë, më tepër se herën e parë, dhe bujqërit

ua bënë gjithashtu. Pastaj u dërgoj të birin, dyke thënë: “Do të kenë turp nga im-bir.” Po bujqërit, kur e panë te birin, thanë me vete: “Ky është trashëgimtari e jani ra vrasim, dhe tja zaptojmë trahëgimin.” Dhe e zunë, dhe e nxuarnë jasht vreshtës, dhe e vranë. Kur të vinjë pra i zoti i vreshtës, ç’ do tu bënë atyre bujqërve?” Dhe ata iu-përgjehnë: “Keq e më keq do t’i humbasë të liqtë; dhe vreshtën do tua japë bujqërve të tjerë, të cilët do tja kthejnë pemët në kohën e tyre.” Dhe Jesuj u tha: “A nuk e kënduat nonjëherë në Shkripturat: ‘Guri, të cilin e çpërthohtë ndërtonjësit, ay u-vu në krye të çipit; këtë e ka bërë Zoti, dhe është e çudiçime në sytë tanë.’ Përandaj po ju them që Mbretëria e Perëndisë do të merret prej jush, edhe do t’i jipet një kombi, i cili siell pemë.”

KORI Lavdi më ty, o Zot, lavdi më ty.

*Pastaj Psalmi 51 pa zë, dhe Litania e Vogël:*

DHJAKU: Përsëri dhe përsëri . . . .

PRIFTI Se ti je Mbreti i Paqes dhe Shpëtimtari i shpirtëve tona, dhe ty të dërgojmë lavdi, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përherë, dhe në jetët e jetëve.

SHKURTORJA, T. T. IV

PAS OS APPARKHAS TIS FISEOS

Jakob i mjerë qan me lot, për lajmën që i bir’ i tij, u-çduk dhe humbi i ngrënë prej bishave, kur ay rronte si një mbret, se në Egjiptë ay nuk u-robërua prej mëkatas, edhe kështu e lavdëroj ay që sheh, të gjitha çipet e zëmrës, dhe u fal kurorë njerësve.

SHTEPIA

Le të qajmë tok me Jakobin, dhe le të derdhim lote, se Josefi i urtë u-shit si rob, po mbeti i lirë nga shpirti, dhe e zotëroj Egjiptën, se Perëndia sipas vlerës u fal kurorë njerësve.

SINAKSARI

Gjithë sot, të Hënën e Shenjtë të Madhe, kujtojmë Josefin e lumur, dhe fikun e mallkuar prej Zotit.

Me nërmjetimet e Josefit të lumur, o Krisht o Perëndi, mëshirona. **Amin.**

*Pastaj Dhjaku thotë.*

DHJAKU: Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës me hymne nderimi le ta madhështojmë.

*Vallet këndojnë Këngën IX të Kanunit; Prifti temjanis.*

KENGA IX

T. II. E nderove pa kufi, Virgjëreshën e pacinuar, o Zoti Krisht Perëndi, se u-mishërove prej asaj nga forma, përandaj ne besnikët me mirënjohje po thërresim: Eni lumërojeni, Zonjën Shën Mari, dhe madhështojeni.

Le të hedhim çdo mëkat, që t’i afrohem Mbretërisë, se na përkrah gjithënjë, Virgjëresha Nëna e Shpëtimtarit; përandaj ne besnikët me mirënjohje po thërresim: Eni lumërojeni, Zonjën Shën Mari, dhe madhështojeni.

Me këshilla o Jesu, i stërvitnje dishepujt’ e lumur, të trashëgojnë lavdi, dhe jetë me nërmjetimet e Virgjëreshës; përandaj ne besnikët me mirënjohje po thërres-

im: Eni lumërojëni, Zonjën Shën Mari, dhe madhështojëni.

### ZBRITESORJA IX

E nderove pa kufi, Virgjëreshën e pacinuar, o Zoti Krisht Perëndi, se u-mishërove prej asaj nga forma, përëndaj ne besnikët me mirënjohje po thërresim: Eni lumërojëni, Zonjën Shën Mari, dhe madhështojëni.

*Pastaj Dhjaku thotë Litaninë e Vogël:*

DHJAKU: Përsëri dhe përsëri, më paqe le t'i lutemi Zotit . . . .

PRIFTI: Se ty të këndojnë gjithë Forcat e qjellit, edhe ty të dërgojmë lavdi, Atit edhe Birit edhe Shpirit të Shenjtë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

### DERGIMESORJA, T. III

#### PAS EPESKEPSATO IMAS

Nusëroren tënde shoh, o Shpëtimtar të stolisur, edhe robë nukë kam, edhe s' kuxonj të hynj n' atë; ndriço-ma pra stolin' o Zot, dhe prit-më dhe shpëto-më, midis të gëzuarve. (3 herë).

### LAVDERIMET, T.I.

*Këndohen katër, dyke i përsëritur që të dyja:*

Kur shkonje o Zot në Jerusalem, u tregonje Apos-tujve, si do të pësonje dhe do të vdisnje, sikundër ishte shkruar. Ejani pra o besnikë, të udhëtojmë me Jesunë, të kryqësohemi dhe të varrosemi, dhe të ngjallemi bashkë me të.

Passi arrimë Pësimin shpëtimtar, të Jesu Krishtit

Perëndi, le ta lavdërojmë me besë, që të na ngjallë ne të vdekurit prej mëkatave, si Perëndi i mëshirave.

### LAVDI DHE TANI, T. T. I.

O Zot kur u-nise për Pësimin vullnetar, u tregonje dishepujve dhe u thoshe: Tani arriu koha, dhe ja ku do të bie në duart' e mëkatarëve, të cilët do më përqeshin, dhe do më kryqësojnë, dhe do më varrosin; po kini kurajë, se do të ngallem pas tri ditësh, për gëzimin e besnikëve, dhe për jetën e ameshuar.

*Pastaj Doksollogjia e Madhe pa zë, dhe Litania e Gjerë:*

DHJAKU: Le tja mbarojmë lutjen tonë mëngjezore Zotit. . . .

PRIFTI: Se ti je Perëndi mëshirëplot edhe njeri-dashës, dhe ty të dërgojmë lavdi, Atit edhe Birit edhe Shpiritit të Shenjtë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

### PASVARGJET, T. T. I

E-jëma e Zebedenjve o Zot, të lypte ofiqe mbretërore për të bitjë, po ti u premtove miqve kupën e vdekjes, për të larë mëkatat. Përëndaj pra të thërresim: O Shpëtimtar i shpirteve, lavdi më ty.

I këshillove disheputjë o Zot, të mos u shëmbëlljnë paganëve, se përpara teje i pari, do të jetë shërbëtori i të gjithëve. Përëndaj pra të thërresim: O Shëptimtar i Shpirteve, lavdi më ty.

Le të marrim shëmbëll nga tharja e fikut, edhe le të sjellim pemë pendimi, që të shpëtojmë nga dënimi, dhe le t'i lutemi Krishtit, të na dhuronjë përdëllimin e math.

## LAVDI DHE TANI T. T. IV.

Drangoj gjeti një Evë Egjptiane, dhe u-përpoq ta gënjente Josefin me lajka; po ay shpëtoj nga mëkati, dyke humbur robën; me lutjet e tij o Krisht mëshirona.

*Pastaj Prifti thotë:*

PRIFTI. Eshtë mirë ta përhirojmë Zotin, edhe ta këndojmë emrin tënt o i Lartë, dhe ta lëçitim mëshirën tënde në mëngjes dhe të vërtetën tënde natën.

*Pastaj Trishenjtë, dhe pa zë Shkurtorja:*

Jakob i mjerë qan me lot, për lajmën që i bir' i tij, u-çduk dhe humbi i ngrënë prej bishave, kur ay rronte si një mbret, se në Egjptë ay nuk u-robërua prej mëkatesh, edhe kështu e lavdëroj ay që sheh, të gjitha çipet e zemrës, dhe u fal kurorë njerësve.

KENDONJESI: Mëshiro, o Zot. (40 herë)

Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve, Amin.

Ti je e nderuar mi Kerubim, dhe e lavdëruar pa përçasje mi Serafim, ti me të vërtetë linde Fjalë Perëndinë, pra ty të madhëtojmë, Zonjë Hyjlindëse.

Mëshiro, o Zot. (3 herë)

Beko, o Atë, më emrin e Zotit.

PRIFTI: I bekuar je, o Krisht o Perëndia ynë, gjithënjë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KENDONJESI: O Mbret qjellor, shiguroji qeveritarët tanë besnikë, përmbaje besën, zbut-i paganët, paqësoje botën, ruaje këtë Kishtë të Shenjtë, vëndos-i atërit edhe vëllezërit e jetëndërruar në tendat e të

Drejtëve; edhe ne prit-na me pendim dhe me rrëfim, si i mirë dhe njeridashës.

## PERLESHIMI

Krishti, Perëndia ynë i vërtetë, që dignoj të pësonjë vullnetarisht për shpëtimin tonë.

## MESHA E PARESHENJTERUAR

*Të Hënë e Madhe në mëngjes bëhet Mesha e Parëshenjtëruar sipas Uratores, f. 149-178, dhe vazhdon gjer në Thirrtoret:*

## THIRRTORET, T. I.

*Këndohen dhjetë, dyke përsëritur katër të parat:*

Kur shkonje o Zot në Jerusalem, u tregonje Apostujve, si do të pësonje dhe do të vdisnje, sikundër ishte shkruar. Ejani pra o besnikë, të udhëtojmë me Jesunë, të kryqësohemi dhe të varrosemi, dhe të ngjallemi baskë me të. (2 here)

Passi arrimë Pësimin shpëtimtar, të Jesu Krishtit Perëndi, le ta lavdërojmë me besë, që të na ngjallë ne të vdekurit prej mëkatave, si Perëndi i mëshirave. (2 here)

O Zot kur u-nise për Pësimin vullnetar, u tregonje dishepujve dhe u thoshe: Tani arriu koha dhe ja ku do të bie në duart' e mëkatarëve, dhe do më kryqësojnë dhe do më varrosin; po kini kurajë, se do të ngjalle pas tri ditësh, për gëzimin e besnikëve, dhe për jetën e ameshuar. (2 here)

E-jëma e Zebedenjve o Zot, të lypte ofiqe mbretërore për të bijtë, po ti u premtove miqve kupën e vdekjes, për të larë mëkatat. Përandaj pra të thërresim: O Shpëtimtar i shpirteve, lavdi më ty. (2 here)

I këshillove dishepujtë o Zot, të mos u shëmbëllojnë paganëve, se përpara teje i pari do të jetë shërbëtori i të gjithëve. Përandaj pra të thërresim: O Shpëtimtar i shpirteve, lavdi më ty.

Le të marrim shëmbëll nga tharja e fikut, edhe le të sjellim pemë pendimi, që të shpëtojmë nga dënimi, dhe le t'i lutemi Krishtit, të na dhuronjë përdëllimin e math.

#### LAVDI DHE TANI, T. T. IV.

Drangoj gjeti një Evë Egjiptiane, dhe u-përpoq ta gënjente Josefin me lajka; po ay shpëtoj nga mëkati, dyke humbur robën; me lutjet e tij o Krisht mëshirona.

*Pastaj bëhet Hyrja e Vogël me Ungjillin: Dhjaku përpara dhe Prifti pas, dalin nga Alltari, qëndrojnë përpara Derës së Bukur, dhe Dhjaku thotë:*

DHJAKU: Urtësi, o të drejtë.

KORI: Dritë gazmore e lavdisë qjellore, Jesu Krisht, si arrimë perëndimin e diellit, edhe pamë dritën e mbrëmës, hymnojmë Atin edhe Birin edhe Shpirtin e Shentjës, se të ka hie kënga kurdoherë, o i Bir' i Perëndisë që fal jetën, përandaj të lavdëron e tërë bota.

*Pas Parëvargut edhe këndimeve nga Dhjata e Vjetër, Dhjaku thotë me zë të lartë:*

DHJAKU. Urdhëro, o Atë.

*Pastaj Prifti merr llambadhen me dorën e mëngjër dhe Temjanicën me të djathtë, qëndron përpara Alltarit, bën shenjën e Kryqit me Temjanicën, pastaj kthehet nga populli, dhe thotë:*

PRIFTI: Urtësi, o të drejtë! Drita e Krishtit u ndrit të gjithëve.

*Pastaj Prifti këndon një herë, dhe Kori dy herë në T.1:*

#### KATEFTHINTHITO I PROSEFKHI MU

Le të drejtohet posi temjani, lutja ime sot, përpara teje; duart' i ngre përpjetë, për mbrëmë si për kurban. (3 herë)

*Pastaj këndohet:*

#### UNGJILLI PAS MATTHEUT

Më atë kohë, kur rrinte Jesuj në malin e Ullinjve, iu-afruan dishepujtë mënjanë, dhe i thanë: "Thuajna, kur do të ngjajnë këto, dhe cila është shenja e ardhjes sate dhe e mbarimit të jetës?" Dhe Jesuj u-përgjeq, edhe u tha: "Shikoni se mos ju gënjenjë njeri; se shumë do të vijnë më emrin tim, dhe do të thonë, 'Unë jam Krishti', dhe do të gënjejnë shumë njerës. Edhe kini për të dëgjuar për luftë dhe tavature luftësh; shikoni, mos u-trëmpni, se të gjitha këto duhet të ngjajnë, po fundi do të vinjë më vonë. Se do të ngrihet komb kundër kombi dhe mbretëri kundër mbretërie; dhe do të ngjajnë zira dhe sëmundje dhe tërmete në shumë vise. Dhe të gjitha këto do të jenë nisja e dhëmbjeve. Ahere do tju zënë, dhe do tju mundojnë, dhe do tju vrasin; dhe do të jini të urryer prej të gjithë kombeve për emrin tim. Dhe ahere shumë do të tronditen, dhe do të tradëtojnë njënjatrin, dhe do të urrejnë njënjatrin. Dhe do të dalin shumë profetër të rremë, dhe do të gënjejnë shumë njerës. Edhe dashuria e të shumëve do të ftohet nga shkaku që do të shtohet paudhësia. Po ay, që do të duronjë gjer në funt, do të shpëtonjë. Dhe ky Ungjill i Mbretërisë do të lëcitet në tërë botën si dëshmim për të gjithë kombet; edhe ahere do të vinjë fundi. Pra, kur të shikoni që mynzyra e shkretimit, e përmëndur prej

Profetit Daniel, qëndron në vëndin e shentjës,—ay, që këndon, le ta marrë vesh—, ahëre ata, që janë në Jude, le të ikin maleve; ay që është në çati, le të mos zbresë për të marrë gjë nga shtëpia, dhe ay, që është në arë, le të mos kthëhet prapa për të marrë robot. Edhe mjerë gratë me barrë dhe ato, që kanë foshnja në krahët ato ditë. Po faluni që ikja juaj të mos ngjanjë as në dimër as të Shtunën. Se ahëre do të jetë një tmerr i math asisoj, që nukë ka ngjarë që nga nisja e botës gjer tani, as ka për të ngjarë nonjë herë tjetër. Edhe sikur të mos shkurtohëshin ato ditë, nukë do të shpëtonte asnjë njeri; po ato ditë do të shkurtohen për hatrin e të zgjedhurve. Ahëre, nëqoftëse dikush ju thotë, ‘Ja Krishti është këtu a aty,’ mos e besoni. Se do të dalin Krishtër dhe profetër, të rremë, dhe do të bëjnë shenja dhe çudira që t’i gënjejnë edhe të zgjedhurit, në muntshin. Pra, nëqoftëse ju thonë, ‘Ja ku është në shkretëtirë’, mos dilni, ose, ‘Ja ku është në dhomat e fshehta,’ mos e besoni. Se si vetëtima, e cila ndrit nga lindja, dhe duket gjer në perëndim ashtu do të jetë edhe ardhja e Birit të njeriut. Se ku të jetë kufoma, atje do të mblidhen shkabat. Edhe menjëherë pas tmerrit të atyre ditëve dielli do të erret, edhe hëna do të shuhet, edhe yjtë do të bien nga qjelli, edhe forcat qjellore do të tronditen. Edhe ahëre do të duket në qjell shenja e Birit të njeriut; edhe ahëre do të lebetiten të gjithë fiset e dheut, kur të shikojnë që i Biri i njeriut vjen nga retë e qjellit me fuqi dhe me lavdi të madhe. Edhe do t’i dërgonjë Engjëjtë me një oshëtimë të madhe prej trumbetash, edhe do t’i mbledhë të zgjedhurit që nga njëra anë e qjellit gjer në tjetrën. Tani mësoni një parabolë nga druri i fikut: Kur dega bëhet e njomë dhe nxier fletë, e dini se vera ashtë afër. Kështu edhe ju, kur t’i shikoni këto të gjitha, dijeni që

është afër, mun në prak të derës. Me të vërtetë po ju them, këto të gjitha do të ngjajnë sa pa shkuar ky brez. Qjelli e dheu do të shkojnë, po fjalët e mia nukë do të shkojnë.

KORI: Lavdi më ty, o Zot, lavdi më ty.

*Pastaj vazhdon Mesha e Dhuratave të Parëshenjtuara.*